



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 08

Prishtinë, më 10. 06. 2011, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Suzana Novoberdaliu – kryetare, Rita Hajzeraj – Beqaj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Kymete Bajraktari, Duda Balje, dhe Justina Shiroka-Pula.

Munguan: Ismet Beqiri dhe Albana Gashi.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi – OSBE, Visar Bivolaku- EULX, Ervin Ibrahimimi UNDP dhe Burim Tahiri - praktikant nga Kuvendi i Kosovës.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Mbledhjen e drejtoi: Suzan Novoberdaliu – kryetare.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 25 majit 2011,
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për personat e zhdukur,
4. Shqyrtimi i disa peticioneve,
5. Marrja e vendimit për formimin e panelit intervistues për përzgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit,
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës.

Rendi i ditës u miratua me heqjen e procesverbalit me arsyetim se nuk ishte përkthyer në gjuhën serbe.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për personat e zhdukur,

Kryetarja – Tha se Projektligji **për personat e zhdukur** me kohë u është shpërndarë deputetëve, por në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit i kërkon Komisionit se projektligji në parim i plotëson kriteret e hartimit të legjislacionit për leximin e parë në seancë parlamentare.

Kymete Bajraktari- I bëri vërejtje nga se ky P/ligj i përcakton kompetencat e Komisionit Qeveritar për persona të pagjetur dhe shumë pak flet për përgjegjësit e familjarëve të të zhdukurve. Ajo tha gjatë amendamentimit të tij se do të japë kontributin që të kemi një ligj të mirë.

Biserka Kostiq- E mirëpriti heqjen e procesverbalit nga rendi i ditës dhe shtoi se P/igji i përshkruan mjaft mirë përgjegjësitë që i ka Komisioni.

Me vjen mirë që disa familjarë të të zhdukurve marrin ndihma. Mirëpo problemin që e paraqes është i lidhur me datat. Në komunitetin tonë kemi të zhdukur edhe pas datës 31 dhjetor të vitit 2000.

Rita Hajzeraj Beqaj- Duke u ndërlidhur me diskutuesit tha se në Projektligjin duhet ta përkrahim në parim, me arsyen e vetme që është kërkesë e familjareve të personave të zhdukur. Komisioni nuk duhet të bëjë dallime në mes etnive të ndryshme, por të gjithë t' i trajtojmë njësoj! Në ligjin duhet ta miratojmë në parim dhe të gjithë të punojmë që në këtë ligj të bëhen ndryshime të mëdha për të mirë, sepse dihet se ky projektligj ka mangësi të shumta.

Kurtan Kajtazi- Meqenëse nga ne, si Komision, kërkohet të raportojmë se a i plotëson Projektligji kriteret për miratim? Në shqyrtim të parë në Kuvend, Projektligji është i hartuar mirë dhe duhet të miratohet. Ne do të jemi kompetent për shqyrtimin e këtij projektligji, do të kemi takime me shoqata të familjarëve të të zhdukurve, me Qeverinë dhe do t'i marrim vërejtjet e tyre. Pastaj do të gjejmë mundësitë për t'i implementuar ato vërejtje në Projektligj dhe do bëjmë një ligj të mirë.

Përfundim

Komisioni në parim e miratoi Projektligjin për personat e zhdukur dhe i rekomandon Kuvendit të Kosovës që të lejojë debat dhe ta miratojë në parim.

4. Shqyrtimi i disa peticioneve

Komisioni vendosi në mbledhjen e radhës të marrë vendim lidhur me kërkesat, pas informatës që ofrojnë raportuesit.

5. Marrja e vendimit për formimin e panelit intervistues për përzgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit

Në vija të trasha kryetarja i njoftoi anëtarët për intervistimin e për procedurat, mënyrën e intervistimit të kandidatëve për zëvendësavokat të Popullit. Pastaj tha do të kemi ndihmën e Komisarariatit të Lartë për të drejtat e njeriut me një ekspert, i cili do të ofrojë ndihmë profesionale, lidhur me procedurat e mëtutjeshme në bashkëpunim me zyrën e personelit.

Komisioni i dha mbështetje Zyrës së personelit të Kuvendit që të hartojë konkursin dhe ta publikojë në mjetet elektronike.

6. Të ndryshme

Rita Hajzeraj Beqaj- Kërkoj të vizitohet ndonjë shtet, i cili është përballur me këtë problem dhe ka eksperiencë në këtë fushë. Ne e dimë që një ligj i tillë ekziston në Bosnjë ose Kroaci dhe një vizitë atje do të na kishte ndihmuar që të bëjmë një ligj të mirë dhe të zbatueshëm.

Kryetarja - duke iu përgjigje parafolësës theksoi : Komisioni nuk mund të udhëtoj në Bosnje dhe Hercegovinë sepse nuk na njohin dokumentet e udhëtimit, si dhe me pak e kushtueshme është që të ftohet ndonjë ekspert në Kosovë dhe në këtë fushë të jap kontributin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit

Suzan Novoberdaliu